



October 31, 2025

Të nderuara familje,

Kemi kënaqësinë të ndajmë me ju se shërbimi i autobusëve të verdhë do të vazhdojë pa ndërprerje. E kuptojmë sa të rëndësishme janë këto shërbime për familjet, dhe arsimi dhe mirëqenia e fëmijës suaj mbeten përparësia jonë kryesore. Mbetemi të përkushtuar për të punuar me kompanitë tona të autobusëve për të arritur një zgjidhje afatgjatë.

E vlerësojmë që kompanitë e autobusëve po sigurojnë akses të pandërprerë në arsim për nxënësit dhe jemi mirënjohës për të gjitha familjet dhe përkrahësit që u bashkuan me ne për të ndihmuar në planifikimin paraprak në rast ndërprerjeje.

Faleminderit për durimin dhe mirëkuptimin tuaj gjatë kësaj periudhe.

Në bashkëpunim,

Melissa Aviles-Ramos

Kancelare, New York City Public Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut)